



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.57, Datë 26.03.2020

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 72, DATË 10.05.2019, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SMART WATT” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, NË ZONËN SHEQ MARINAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË BASHKIA FIER”.

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 26.03.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur, nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 72, datë 10.05.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 MW, në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë Bashkia Fier”,

Konstatohet se:

- Me Vendimin nr. 72, datë 10.05.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur:
 1. *Të licencojë shoqërinë “SMART WATT” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me fuqi të instaluar 2 MW, në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier për një afat 25 vjeçar.*
 2. *Para vënies në punë të centralit, shoqëria “SMART WATT”, sh.p.k, të depozitohet në ERE miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit apo shpërndarjes.*
- Në vijim të kësaj vendimmarrje,, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 514, datë 24.02.2020, për të marrë informacion në lidhje me ecurinë e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të sipërcituar.
- Shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 21 prot., datë 27.02.2020, protokolluar në ERE me nr. 514/1 prot, datë 26.02.2020, bashkëlidhur së cilës ka depozituar në ERE dokumentacionin si vijon:
 - Preventivin nr. 17090 prot, datë 06.08.2019, të OSHEE, “Për miratim pikë lidhje për Centralin Fotovoltai SMART WATT”.
 - Shkresën nr. 17090/1 prot, datë 18.11.2019, të OSHEE drejtuar shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., “Ofertë për lidhjen e burimit të ri gjenerues në rrjetin shpërndarës”.

- Shkresën nr. extra prot, datë 19.11.2019, të shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., drejtuar OSHEE, “Pranim i ofertës për lidhjen e burimit të ri gjenerues në rrjetin OSHEE”.
- Marrëveshjen e lidhjes së re, me nr. 17090/2 prot, datë 19.11.2019, të lidhur mes OSHEE dhe shoqërisë “SMAR WATT” sh.p.k., me objekt lidhjen e burimit gjenerues në rrjetin e shpërndarjes, me adresë Sheq Marinas, Topojë, Fier.
- Shkresën nr. 17090/3 prot, datë 20.11.2019, të OSHEE drejtuar shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., për dijëni Drejtorisë së Tensionit të Lartë, “Miratim pikë lidhje central fotovoltaiq”, nëpërmjet së cilës miratohet lidhja e centralit fotovoltaiq të shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet zbarave 35 kV të nënstacionit Hoxharë 35/10 kV.

Rezulton se shoqëria “SMART WATT” sh.p.k., ka depozituar në ERE dokumentacionin e kërkuar sipas përcaktimeve të vendosura në pikën 2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 72, datë 10.05.2019, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtin e vendosur në vendimin e licencimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Në vendimin e bordit të ERE-s nr. 72, datë 10.05.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq, me kapacitet të instaluar 2 MW, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë Bashkia Fier” bëhet ndryshimi si më poshtë:
 - a. Pika 2 shfuqizohet.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palën e interesit dhe OSSh sh.a për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI